



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 183/1 prot.

Tiranë, më 21.02.2022

VENDIM
Nr.28, datë 21.02.2022

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 126, DATË 26.10.2021

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 126, datë 26.10.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e statusit të punësimit, të punonjësit *****, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. 294 prot., datë 11.9.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet kërkesës së Kryetarit të Bashkisë Kamëz, protokolluar me nr. 792 prot, datë 13.9.2021, është ngritur pretendimi se ka paqartësi në lidhje me statusin e punësimit të punonjësit *****, i punësuar në pozicionin e punës, “Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, pranë kësaj bashkie.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni Bashkia Kamëz të gjithë materialin shkresor për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, kreu III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Verifikimi i informacionit të mësipërm u krye nëpërmjet një takimi të organizuar me përfaqësues të Bashkisë Kamëz, ku u analizua përmbajtja e dosjes personale të punonjësit.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ, procesi është përmbyllur me Vendimin nr.126, datë 26.10.2021, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e statusit të punësimit, të punonjësit *****, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. 294 prot., datë 11.9.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 10058/1 prot., datë 3.11.2021, *“Kthim përgjigje”*, në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur aktin e largimit nga detyra të punonjësit në fjalë.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 126, datë 26.10.2021, si dhe duke verifikuar veprimin administrativ të kryer nga njësia përgjegjëse, i materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i hetimit administrativ paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Kamëz rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësën ***** dhe pozicioni i mbajtur prej tij të shpallet i lirë, për t’u plotësuar më pas sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

Konstatohet se, nga ana e institucionit janë marrë masa për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë. Konkretisht, me aktin nr. 548, datë 29.10.2021, *“Largim nga puna”*, Bashkia Kamëz ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit për punonjësën *****.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 126, datë 26.10.2021, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e statusit të punësimit, të punonjësit *****, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Specialist në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. 294 prot., datë 11.9.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Kamëz, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 126, datë 26.10.2021.

3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kamëz dhe nëpunësi *****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha